**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada – Government*
**Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister**
***Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo***

## Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

# Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi

## TM2 -2012 (2005 = 100 )



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

# P a r a th ë i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës përkatësisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, ka filluar të grumbulloj të dhëna për çmimet e prodhimeve bujqësore që nga Nëntori i vitit 2003. Në fillim numri i artikujve ishte i kufizuar. Aktualisht çmimet grumbullohen për 64 prodhime të ndryshme bujqësore. Në të ardhmen është planifikuar të rritet numri i prodhimeve çmimet e të cilave do të monitorohen dhe do të plotësohen me indeksin e çmimeve të inputeve. Ky është publikimi i njëzet e njitë mbi indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore dhe çmimet mesatare absolute të prodhimeve bujqësore përgatitur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Në këtë publikim, indeksi i çmimeve të prodhimeve bujqësore është paraqitur për disa prodhime kryesore bujqësore.

ASK falënderon Agjencionin Ndërkombëtar Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) për mbështetjen e tyre për ndërtimin e sistemit të statistikave agromonetare. ASK gjithashtu falënderon për bashkëpunim të gjithë bashkëpunëtorët e zyrave rajonale të ASK, bashkëpunëtorët tjerë (respondentët) e pikave-vendeve të grumbullimit të çmimeve si: fermat bujqësore, ndërmarrjet industriale, tregtare etj.

Falënderojmë në veçanti ekspertët Suedez të statistikave të çmimeve, Z. Tomas Eriksson, Z. Jimmie Enhall këshilltaren afatgjatë të statistikave Suedeze Znj. Milva Ekonomi dhe të tjerët që në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekt ndihmuan në finalizimin e këtij publikimi.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet lidhur me këtë publikim mund ti dërgoni në email adresën e departamentit; **E- mail: agriculture@ks-gov.net**

Publikimin e përgatitën:

Bajrush Qevani - Drejtor i departamentit,
Haki Kurti - Shef i divizionit,
Violeta Arifi – Gashi - Shefe e sektorit,
Kademsha Bajramaga - Zyrtare e lartë.

Kryeshef Ekzekutiv i ASK -së,
Isa Krasniqi

Gusht 2012

# Lista e shkurtesave

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

IÇPB - Indeksi i Çmimeve të Produkteve Bujqësore

BE - Bashkësia Evropiane

SIDA - Agjencioni Ndërkombëtarë i Suedisë për Zhvillim dhe Kooperim

TM2 - Tremujori i Dytë

# Simbolet

. Të pa – aplikueshme

‰ Promil

Në tabelat ku janë dhënë peshat numrat janë rrumbullakuar deri në shifrën e fundit më të afërt për këtë arsye mund të ketë një mospërputhje të lehtë të shumave.

# P ë r m b a j t j a

Faqe

Indeksi i çmimeve të prodhimeve bujqësore,TM2.(2005=100 )............................................................6

Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore prill – qershor 2012 (2005=100 )............................7

Ndryshimet e indeksit mujor të çmimeve të prodhimeve bujqësore 2011/2012....................................8

Çmimet mesatare mujore për disa prodhime bujqësore.........................................................................9

Metodologjia..............................................................................................................................12

Pyetësori.................................................................................................................................14

# Indeksi i çmimeve të prodhimeve bujqësore

Publikimi përfshin të dhëna prej muajit prill deri në qershor të vitit 2012,(2005 = 100). Për të bërë krahasime dhe për të vërejtur ndryshimet janë prezentuar të dhëna për tremujoret e dytë (TM2) të viteve 2005 – 2012
Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma, dhe vendet tjera ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen.

Prodhimet të cilat krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe; drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për kafshët dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve; gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në Euro dhe njësitë matëse janë në kg, litër dhe copë.

Grafiku 1,2 dhe 3 prezanton indeksin mujor të çmimeve të prodhimeve bujqësore për periudhën janar- dhjetor 2011 dhe tremujori i dytë i vitit 2012 për prodhimet bimore dhe blegtorale. Gjithashtu prezenton totalin e prodhimeve bujqesore dhe vitin bazë 2005 = 100.

Në tremujorin e dytë të vitit 2012 indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 6.5 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2011 Indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rënie për - 4.4 % në tremujorin e dytë të vitit 2012 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2011. Indeksi total i prodhimeve bujqësore ka rritje për 0.4 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2011.

**Grafiku 1: Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bimore, janar- dhjetor 2011 dhe tremujori i dytë 2012 , (2005=100)**



**Grafiku 2: Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve blegtorale, j janar- dhjetor 2011 dhe tremujori i dytë 2012 , (2005=100)**




**Grafiku 3: Indeksi mujor total i çmimeve të prodhimeve bujqësore, janar- dhjetor 2011 dhe tremujori i dytë 2012 , (2005=100)**



# Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësoreTM2 2005-2012 (2005=100)

### Tabela 1: Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore TM2 2005 - 2012 (2005 = 100)

| Kodi i IÇPB | Përshkrimi | TM2-2005 | TM2-2006 | TM2-2007 | TM2-2008 | TM2-2009 | TM2-2010 | TM2-2011 | TM2-2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **010000** | **DRITHËRAT (përfshirë farërat )** | **99,5** | **96,6** | **111,0** | **207,9** | **125,9** | **108,3** | **174,1** | **169,5** |
| 011000 | Grurë dhe spelt (spelt = Triticum aestivum spelta) | 100,2 | 106,4 | 126,6 | 232,8 | 142,0 | 108,0 | 192,8 | 173,9 |
| 011100 | Grurë i butë dhe speltë | 100,2 | 106,4 | 126,6 | 232,8 | 142,0 | 108,0 | 192,8 | 173,9 |
| 012000 | Thekërë dhe meslin (meslin =përzierje gruri dhe thekëre, lloj drithi) | 100,2 | 106,4 | 126,6 | 253,0 | 148,5 | 139,2 | 187,6 | 198,0 |
| 013000 | Elb | 99,7 | 106,0 | 126,1 | 216,0 | 163,0 | 125,7 | 158,9 | 187,5 |
| 013200 | Elb për prodhimin e birrës | 99,7 | 106,0 | 126,1 | 216,0 | 163,0 | 125,7 | 158,9 | 187,5 |
| 014000 | Tërshër dhe perzierje të drithërave verore | 100,2 | 106,4 | 126,6 | 215,0 | 121,5 | 108,3 | 151,3 | 161,7 |
| 015000 | Misër kokërr | 98,8 | 84,1 | 91,2 | 183,9 | 96,4 | 100,7 | 166,5 | 158,1 |
| **030000** | **BIMË FORAGJERE** | **103,4** | **102,9** | **121,2** | **205,5** | **135,2** | **117,8** | **146,7** | **137,5** |
| 031000 | Misër për ushqim kafshësh | 95,2 | 84,7 | 92,0 | 179,0 | 97,0 | 101,4 | 173,5 | 158,4 |
| 032000 | Kultura tuberoze për ushqim kafshësh (përfshirë panxharin foragjerë) | , | , | , | , | , | , | , | . |
| 039000 | Bimë tjera foragjere | 103,5 | 103,1 | 121,5 | 205,8 | 135,6 | 118,0 | 146,5 | 137,3 |
| **040000** | **PERIME DHE PRODUKTE TJERA HORTIKULTURORE** | **128,5** | **146,9** | **128,9** | **154,9** | **125,2** | **145,0** | **137,5** | **149,6** |
| 041000 | Perime të freskëta | 128,5 | 146,9 | 128,9 | 154,9 | 125,2 | 145,0 | 137,5 | 149,6 |
| 041100 | Lulelakër | , | , | , | , | , | , | , | , |
| 041200 | Domate | 160,7 | 188,8 | 159,4 | 175,7 | 171,2 | 145,4 | 150,2 | 180,5 |
| 041900 | Perime tjera të freskëta | 121,4 | 137,6 | 122,2 | 150,3 | 115,1 | 144,9 | 134,7 | 142,8 |
| 042000 | Bimë dhe lule | , | , | , | , | , | , | , | , |
| **050000** | **PATATE (përfshirë farërat)** | **126,0** | **143,4** | **164,9** | **152,1** | **140,8** | **163,5** | **195,3** | **105,7** |
| 051000 | Patate për konsum | 126,0 | 143,4 | 164,9 | 152,1 | 140,8 | 163,5 | 195,3 | **105,7** |
| **060000** | **PEMË** | **95,9** | **94,6** | **118,3** | **123,7** | **123,4** | **113,7** | **123,4** | **151,7** |
| 061000 | Pemë të freskëta pa i përfshirë agrumet dhe rrushin | 95,9 | 94,6 | 118,3 | 123,7 | 123,4 | 113,7 | 123,4 | 151,7 |
| 061100 | Mollë tryeze | , | , | , | , | , | , | , | , |
| 061200 | Dardhë tryeze | , | , | , | , | , | , | , | , |
| 061300 | Pjeshkë | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 138,1 | 105,6 | 95,3 | 95,3 | 110,4 |
| 061900 | Pemë të freskëta arrë,lajthi,gështenjë dhe fruta të tharë | 95,8 | 94,6 | 118,4 | 123,6 | 123,6 | 113,8 | 123,6 | 152,0 |
| 062000 | Agrume | , | , | , | , | , | , | , | , |
| 063000 | Pemë tropikale | , | , | , | , | , | , | , | , |
| 064000 | Rrush | , | , | , | , | , | , | , | , |
| **100000** | **PRODHIMI I KULTURAVE BIMORE (010000 gjer në 090000), përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)** | **119,3** | **131,1** | **130,7** | **168,1** | **129,0** | **137,8** | **153,5** | **146,8** |
| **101000** | **PRODHIMI I KULTURAVE BIMORE (010000 gjer në 090000), pa i përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)** | **110,3** | **115,5** | **133,6** | **186,8** | **133,9** | **131,2** | **174,4** | **137,3** |
| **110000** | **BLEGTORIA** | **96,7** | **102,1** | **99,0** | **107,1** | **124,1** | **117,9** | **122,2** | **130,8** |
| 111000 | Gjedhët | 96,1 | 104,1 | 100,0 | 105,4 | 123,6 | 115,3 | 120,4 | 129,4 |
| 111100 | Gjedhët pa i përfshirë viçat | 96,1 | 104,1 | 100,0 | 105,4 | 123,6 | 115,3 | 120,4 | 129,4 |
| 111200 | Viçat | 96,1 | 104,1 | 100,0 | 105,4 | 123,6 | 115,3 | 120,4 | 129,4 |
| 112000 | Derrat | 101,3 | 100,5 | 98,7 | 124,1 | 140,1 | 136,3 | 129,4 | 141,9 |
| 113000 | Njëthundrakët ( Kuaj,Gomarë,Mushka) | 96,7 | 102,1 | 99,0 | 107,1 | 124,1 | 117,9 | 122,2 | 130,8 |
| 114000 | Dele dhe dhi | 97,2 | 93,8 | 93,9 | 105,3 | 118,1 | 117,6 | 120,4 | 127,5 |
| 115000 | Shpezët | 100,0 | 104,9 | 108,2 | 146,5 | 159,7 | 173,3 | 187,4 | 190,3 |
| 115100 | Pulat | 100,0 | 104,9 | 108,2 | 146,5 | 159,7 | 173,3 | 187,4 | 190,3 |
| 115900 | Shpezët tjera | 100,0 | 104,9 | 108,2 | 146,5 | 159,7 | 173,3 | 187,4 | 190,3 |
| 119000 | Kafshë tjera | , | , | , | , | , | , | , | , |
| **120000** | **PRODHIMET BLEGTORIALE** | **101,5** | **96,1** | **98,9** | **116,2** | **100,3** | **96,5** | **109,2** | **115,4** |
| 121000 | Qumësht | 100,5 | 105,0 | 101,4 | 128,5 | 114,3 | 103,3 | 110,7 | 113,8 |
| 121100 | Qumësht lope | 100,5 | 105,0 | 101,4 | 128,5 | 114,3 | 103,3 | 110,7 | 113,8 |
| 121900 | Lloje tjera qumshti | , | , | , | , | , | , | , | |
| 122000 | Vezë | 103,3 | 82,2 | 95,7 | 100,3 | 78,3 | 84,7 | 105,3 | 117,2 |
| 129000 | Produkte tjera blegtorale | 100,5 | 99,8 | 95,7 | 98,5 | 104,6 | 106,7 | 119,0 | 119,0 |
| **130000** | **BLEGTORIA DHE PRODHIMET BLEGTORIALE (110000+120000)** | **98,7** | **99,6** | **99,0** | **110,9** | **113,9** | **108,8** | **116,6** | **124,2** |
| **140000** | **GJITHSEJ PRODHIMET BUJQËSORE (100000+130000), përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)** | **108,9** | **115,1** | **114,6** | **139,1** | **121,4** | **123,1** | **134,8** | **135,4** |
| **141000** | **GJITHSEJ PRODHIMET BUJQËSORE (100000+130000), pa përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)** | **102,2** | **104,4** | **109,4** | **133,9** | **120,0** | **115,5** | **134,1** | **128,2** |

# Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore

## Tabela 2: Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, prill- qershor 2012 (2005 = 100)

| Kodi i artikullit | Grupet | Peshat | | 2012 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ‰ | 1000 Euro | Pri | Maj | Qer |
| **0 1** | **Drithërat** | **88** | **8 018** | **168,5** | **170,0** | **170,8** |
| 0 1.1 | Grurë | 45 | 4 105 | 173,7 | 174,2 | 173,8 |
| 0 1.3 | Elb | 10 | 904 | 186,3 | 188,2 | 188,2 |
| 0 1.5 | Misër | 31 | 2 818 | 155,7 | 158,2 | 161,4 |
| 0 1.9 | Drithëra tjera | 2 | 191 | 160,4 | 168,5 | 161,5 |
| **0 3** | **Bimët foragjere** | **63** | **5 726** | **143,9** | **135,4** | **133,6** |
| 0 3.1 | Misër për ushq. kafshëve | 0 | 36 | 156,1 | 153,6 | 161,8 |
| 0 3.9 | Bimët tjera foragjere | 62 | 5 690 | 143,9 | 135,2 | 133,1 |
| 0 3.9.1 | Sanë | 29 | 2 682 | 150,0 | 140,2 | 127,7 |
| 0 3.9.2 | Kashtë | 14 | 1 234 | 147,3 | 138,1 | 142,2 |
| 0 3.9.9 | Bimët tjera foragjere ;tjera | 19 | 1 774 | 130,0 | 118,3 | 114,0 |
| **0 4** | **Perimet** | **351** | **31 942** | **116,4** | **147,2** | **164,8** |
| 0 4.1 | Perimet e freskëta | 351 | 31 942 | 116,4 | 147,2 | 164,8 |
| 0 4.1.2 | Domate | 30 | 2 716 | . | 197,6 | 163,4 |
| 0 4.1.9 | Perimet tjera të freskëta | 321 | 29 226 | 116,4 | 128,9 | 165,0 |
| 0 4.1.9 | Speca | 211 | 19 234 | . | 127,4 | 183,5 |
| 0 4.1.9.1 | Lakër | 24 | 2 209 | . | . | 136,0 |
| 0 4.1.9.4 | Tranguj | 11 | 1 009 | . | 154,7 | 123,1 |
| 0 4.1.9.6 | Qepë | 19 | 1 729 | 92,8 | 98,6 | 106,3 |
| 0 4.1.9.7 | Fasulja | 31 | 2 825 | 138,8 | 143,4 | 136,9 |
| 0 4.1.9 | Shalqi | 10 | 936 | . | . | . |
| 0 4.1.9.9.9 | Perimet tjera të freskëta: tjera | 14 | 1 283 | 96,2 | 109,3 | 123,8 |
| **0 5** | **Patatet** | **121** | **10 989** | **69,4** | **59,0** | **162,8** |
| **0 6** | **Pemët** | **50** | **4 567** | **152,2** | **189,9** | **140,7** |
| 0 6.1 | Pemët e freskëta | 23 | 2 108 | 152,2 | 189,9 | 140,7 |
| 0 6.1.1 | Molla | 8 | 704 | . | . | . |
| 0 6.1.2 | Dardha | 3 | 248 | . | . | . |
| 0 6.1.9 | Pemët tjera | 13 | 1 156 | 152,2 | 189,9 | 140,7 |
| 0 6.1.9.2 | Kumbulla | 5 | 491 | . | . | . |
| 0 6.1.9.4 | Frutat e thata,Gështenjë | 3 | 306 | 152,2 | 143,5 | 152,2 |
| 0 6.1.9.9 | Pemët tjera,të tjera | 4 | 359 | . | 193,5 | 140,3 |
| 0 6.4.1 | Rrushi | 15 | 1 354 | . | . | . |
| 0 6.4.9 | Rrush për verëra | 12 | 1 105 | . | . | . |
| **10** | **Prodhimet bimore** | **673** | **61 241** | **120,0** | **136,4** | **160,5** |
| **11** | **Blegtoria** | **188** | **17 086** | **130,0** | **129,5** | **133,1** |
| 11.1 | Mëzet dhe Mëshqerra | 140 | 12 739 | 128,7 | 128,7 | 130,8 |
| 11.2 | Derra | 9 | 791 | 135,9 | 135,9 | 154,1 |
| 11.4 | Dele | 34 | 3 129 | 127,0 | 124,7 | 130,7 |
| 11.5 | Pula | 4 | 345 | 191,6 | 187,9 | 191,6 |
| 11,9 | Kafshë -tjera | 1 | 82 | 130,0 | 129,5 | 133,1 |
| **12** | **Prodhimet blegtorale** | **140** | **12 722** | **121,4** | **116,4** | **108,4** |
| 12.1 | Qumësht | 79 | 7 194 | 115,0 | 114,0 | 112,4 |
| 12.2 | Vezë | 52 | 4 760 | 119,0 | 119,0 | 119,0 |
| 12.9 | Prodhimet tjera blegtorale | 8 | 768 | 119,0 | 119,0 | 119,0 |
| **13** | **Blegtoria dhe prodhimet blegtorale** | **327** | **29 808** | **126,3** | **123,9** | **122,5** |
| **14** | **Totali i prodhimeve bujqësore** | **1000** | **91 049** | **122,1** | **132,3** | **148,1** |

# Agjencia e Statistikave të Kosovës

*përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** *ka këtë strukture organizative:* ***Departamentet prodhuese;*** *(Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale.* ***Departamentet mbështetëse;*** *(Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti i administratës.* ***Ne kuadër të*** **Agjencionit** ***vepron edhe*** *Zyra për regjistrimin e popullsisë ekonomive familjare dhe banesave* si dhe ***Zyrat Rajonale:*** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%), Agjencioni ka ketë strukture kualifikuese, 65.4% me shkollim universitar ndaj 34.6% me shkollim te mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministritë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID,UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikat e shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistrues terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe banesave,i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë qe t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.


- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
  Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 143
  Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax:**: +381 (0) 38 235 033
- **E-mail: agricultural@ks-gov.net**
- **Ueb-faqe: http://esk.rks-gov.net**